

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: Shërbim Lavanderie, e ndarë në 2 (dy) lote:**

- 1. Loti 1: Shërbim Lavanderie për Spitalin Rajonal Lezhë**
- 2. Loti 2: Shërbim Lavanderie për Spitalin Rajonal Berat**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP): 42716000-8.**

VLERA E FONDIT LIMIT: 40,117,437.63 (dyzet milion e njëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e shtatë pikë gjashtëdhjetë e tre) lekë pa Tvsh, ose 399,735.33 (treqind e nëntëdhjetë e nëntëmijë e shtatëqind e tridhjetë e pesë pikë tridhjetë e tre) euro, **e ndarë në 2 (dy) lote**, si më poshtë:

- **Loti 1** me fond limit në vlerën 27,784,005.63 (njëzet e shtatë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e katërmijë e pesë pikë gjashtëdhjetë e tre) lekë pa Tvsh, ose 276,843.42 (dyqind e shtatëdhjetë e gjashtëmijë e tetëqind e dyzet e tre pikë dyzet e dy) Euro;
- **Loti 2** me fond limit në vlerën 12,333,432 (dymbëdhjetë milion e treqind e tridhjetë e tremijë e katërqind e tridhjetë e dy) lekë pa TVSH, ose 122,891.91 (njëqind e njëzet e dymijë e tetëqind e nëntëdhjetë e një pikë nëntëdhjetë e një) Euro.

*(Vlera në Euro është konvertuar referuar Kursit zyrtar të këmbimit zyrtar (100.36), datë 06.06.2024, ora: 12:00.)*

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

**LOTI 1: SHËRBIM LAVANDERIE PËR SPITALIN RAJONAL LEZHË**

**KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 11;*

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 5;

## 2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

### 2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kritereve të përgjithshme të kualifikimit, të vendosura në pikën 1 të shtojcës 10 të DST.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", duke vlerësuar që plotësimi i kritereve të përgjithshme të kualifikimit, të vendosura në pikën 1 të shtojcës 10 të DST provon mjaftueshëm përshtatshmërinë profesionale të ofertuesve.

### 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2021-2022-2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përllogaritur e fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/a, pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

**2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2021, 2022, 2023), të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentim:** Kriteri vendoset bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP; të nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 41 të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Kriteri ekonomik dhe financiar i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar sigurinë se operatorët ekonomik kanë kapacitet financiar për zbatimin e marrëveshjes kuadër.

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 39 % të vlerës së fondit të limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar marrëveshjen kuadër, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike. Garancia mbi përvojën e ngjashme është e rëndësishme, duke mbajtur në konsideratë natyrën e objektin e prokurimit, që lidhet drejtëpërdrejtë me shërbimin e pacientëve në spital.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë në pronësi, qira ose në përdorim **të paktën 1 (një) ambient, ku shtron veprimtarinë për kryerjen e shërbimit lavanderisë objekt prokurimit.**

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- dokumentacionin që vërteton pronësinë, ose qiramarrjen, ose huapërdorjen (certifikatë pronësie/ kontrata qiraje/ kontrata huapërdorje/ çdo dokument tjetër të vlefshëm, me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).
- akt miratimi higjeno – sanitar për këtë ambient, lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.

Të dhënat e ambientit të kërkuar që do të deklarohet, detyrimisht do t'i paraqiten Autoritetit Kontraktor, për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Nisur nga fakti se shërbimi, objekt prokurimi është lavanderia, vlerësohet e nevojshme që operatori ekonomik duhet të disponojë një ambient për kryerjen e këtij shërbimi dhe të gjitha proceseve të punës, që ky shërbim përfshin, si: larje, tharje, hekurosje, paketim. Disponimi minimalisht i 1 (një) ambjenti ku ushtron aktivitetin e tij, i cili plotëson kushtet higjeno-sanitare, siguron AK që shërbimi i lavanderisë, objekt prokurimi, do të kryeht në kohë, cilësi dhe konform kushteve higjeno-sanitare.

Pajisja me aktin higjeno-sanitar e këtij ambienti, është vendosur bazuar në Ligjin nr. 7643 datë 02.12.1992 ”Për inspektimin sanitar”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 139, datë 14.4.2011, “Për lëshimin e akt miratimit higjeno-sanitar”, Udhëzimin nr.510, datë 13.12.2011, “Për inspektimet higjeno-sanitare në funksion të lëshimit të akt miratimit higjeno-sanitar, si dhe duke mbajtur në vëmendje rëndësinë që ka ruajtja dhe plotësimi i kushteve të higjenës, për këtë shërbim, i cili lidhet drejtëpërdrejt me shëndetin e pacientëve në spitale.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë dhe të paraqesë çertifikatë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, dhe të jetë e vlefshme, si më poshtë si më poshtë:

- **SSH EN 14065:2016** mbi “Sistemin e kontrollit të Biokontaminimit”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e kontrollit të Biokontaminimit. Nisur nga rëndësia dhe frekuencat e kryerjes së proceseve të shërbimit, objekt prokurimi, është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojë se ka një sistem të tillë, pra të demonstrojë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte që plotësojnë kërkesat AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit ndaj klientit, pra Ak-së. Ky standard evropian përshkruan një qasje të menaxhimit të rrezikut, të quajtur analiza e rrezikut dhe kontrollit të biokontaminimit (RABC), i projektuar për të lejuar pastrimin e produkteve të vazhdueshme për të siguruar cilësinë mikrobiologjike të indeve të trajtuara në lavanderi, pra lidhet ngushtësisht me objektin e prokurimit, pasi pjesa kryesore e objektit të prokurimit është larja e materialeve, të cilat pasi të lahen do të përdoren për shtretërit e pacientëve të sëmurë, apo personelit mjekësor, si dhe për sallat e operacioneve, ku çdo gjë duhet të jetë sa më sterile dhe e pastër.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë leje mjedisore të Tipit B “Pastrim kimik” (të vlefshme), lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), për vendin ku ushtron këtë aktivitet, në fushën e objektit të prokurimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 5, gërma c.) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe Ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011 ”Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar, Ligjit nr. 52/2020 ”Për disa ndryshime në ligjin nr.10448, datë 14.07.2011 ”Për lejet e mjedisit”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë lejen mjedisore që parashikohet nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore.

Pajisja me këtë leje mjedisore, siguron AK që ofertuesit ushtrojnë aktivitetin e tyre në zbatim kërkesave ligjore mjedisore, si dhe shërben si garanci që ekzekutimi i marrëveshjes kuadër, do të kryhet nga OE në përputhje me standartet e kërkuara ligjore dhe cilësinë e shërbimit, që kërkohet të ofrohet.

2.3.5 Operatori/ët ekonomik pjesëmarrës për të realizuar shërbimin objekt prokurimi, duhet të ketë minimalisht 7 (shtatë) persona të punësuar, në profilet sipas tabelës si mëposhtme:

NR.	Stafi	Nr.
a)	Drejtues Teknik	1 (një)
b)	Punëtore në Lavanderi	3 (tre)
c)	Punonjës shërbimi në Reparte të AK	3 (tre)
	<b>Totali i punonjësve</b>	<b>7(shtatë)</b>

- a) Drejtuesi Teknik duhet të ketë eksperiencë pune të ngjashme të paktën 2 (dy) vite.  
Për Drejtuesin Teknik, OE duhet të paraqesë:
- Kontratë individuale pune (e vlefshme), si drejtues teknik;
  - Diplomë e arsimit të lartë;
  - Librezë pune/ deklaratë e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/ cv dhe/ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton ekpseriencën e kërkuar.
- b) Për punonjësit Punëtor në Lavanderi, dhe punonjësit e shërbimit në Reparte të AK të paraqiten vetëm kontratë individuale pune (e vlefshme) përkatëse.

Të dhënat për punonjësit e kërkuar që do të deklarohen, detyrimisht do t’i paraqiten Autoritetit Kontraktor për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

*Kriteri konsiderohet i permbyshur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 11 të DT.*

*Dokumentet provuese të kërkuar më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit,ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për punonjësit vendoset nga një analizë e natyrës së objektit të prokurimit, specifikimeve teknike, frekuencës së ekzekutimit të kontratës/ava, që do të lidhen dhe termave të referencës, hartuar nga AK.

Në tabelën e mësipërme është përcaktuar numri minimal i punonjësve, të cilët vlerësohen të nevojshëm për kryerjen e proceseve të punës, të cilat përfshin shërbimi i lavanderisë, si më poshtë: Drejtuesi teknik ka një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e shërbimit të lavanderisë, dhe të gjitha proceseve të punës, të përfshirë në këtë proces, duke mbajtur përgjegjësi për zbatimin e objektit të prokurimit, në përmbushje të standarteve të cilësisë, specifikimeve teknike, dhe kushteve teknike të kërkuara. Vitet e eksperiencës së drejtuesin teknik, janë vendosur duke mbajtur në konsideratë rëndësinë e shërbimit, objekt prokurimi dhe kryerjen e tij në përputhje cilësinë dhe me oraret e vendosura nga AK.

Disponimi i punëtorëve në lavanderi siguron AK që ofertuesit zotërojnë personelin e nevojshëm për të kryer proceset e larjes, tharjes, hekurosjes, paketimit, në kohë dhe me cilësinë e kërkuar.

Punonjës shërbimi në reparte janë të nevojshëm për të kryer proceset e marrjes së materialeve nga spitali dhe transportimin e tyre në spital.

Numri i punonjësve të kërkuar është caktuar duke u bazuar në natyrën dhe numrin e shërbimeve, objekt prokurimi dhe proceset e punës në të cilat duhe të përmbushë ky shërbim.

Dokumentacioni i kërkuar për punonjësit shërben si provë/dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

2.3.6 Operatorët ekonomikë ofertues duhet të deklarojnë se punonjësit e deklaruar për këtë procedurë prokurimi: Drejtuesi Teknik dhe Punonjës shërbimi në Reparte të AK nuk do të jenë të angazhuar në kontrata të tjera gjatë periudhës së vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër.

#### **Argumentimi:**

Në zbatim të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, si dhe duke vlerësuar ndjeshmërinë e shërbimeve, objekt prokurimi, ku kërkohet një shërbim i përditshëm, drejtuesi teknik dhe punonjësit e shërbimit në reparte të AK kërkohet të mos jenë të angazhuar në kontrata të tjera gjatë periudhës së vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër, duke garantuar kështu ekzekutimin e kontratës/kontratave që do të nënshkruhen në zbatim të marrëveshjes kuadër, në kohë dhe cilësi. Realizimi në kohë i shërbimit është shumë i rëndësishëm për këtë procedurë prokurimi, pasi lidhet drejtëpërdrejtë me shërbimin ndaj pacientëve në spitale.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se disponon, makineritë, dhe pajisjet, si më poshtë:

<b>Nr</b>	<b>Emri i mjetit</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasitë minimale</b>	<b>Statusi</b>
1	Makine larëse Profesionale (me kapacitet mbi 60 kg secila)	Cope	2 (dy) ose me kombinim pajisjesh, për plotësimin e sasisë se përcaktuar nga AK.	Në pronësi ose me qira, ose përdorim
2	Makinë Pastrimi Kimik Profesionale, (me kapacitet mbi 20 kg)	Copë	1 (një) ose me kombinim pajisjesh, për plotësimin e	Në pronësi ose me qira, , ose përdorim

			sasisë se përcaktuar nga AK.	
3	Makinë tharese profesionale (me kapacitet mbi 20 kg secila)	copë	2 (dy) ose me kombinim pajisjesh, për plotësimin e sasisë së përcaktuar nga AK	Në pronësi ose me qira, ose përdorim
4	Makinë Hekurose (Rul) Profesionale	Copë	1 (një)	Në pronësi ose me qira, ose përdorim
5	Peshore elektronike mbi 100 kg e cila duhet të jete kalibruar dhe të shoqërohet me akt kolaudimi të leshuar nga autoritetet perkatese( Drejtoria e Pergjithshme e Metrologjise)	Copë	1 (një) ose me kombinim pajisjesh, për plotësimin e sasisë se përcaktuar nga AK.	Në pronësi ose me qira, ose përdorim

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet:

dokumentacion për pajisjet dhe instrumentet e mësipërme, që vërtetojnë se, këto pajisje dhe instrumente i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Të dhënat për pajisjet e kërkuara që do të deklarohen detyrimisht do t'i paraqiten Autoritetit Kontraktor, për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

*Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 11 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit,ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet për kryerjen e shërbimit të lavandersisë dhe të gjitha proceseve të tij, si: larje, tharje, hekurosje.

Nisur nga specifikimet teknike të materialeve, për të cilat do të kryhet procesi i larjes, dhe konkretisht i jastekeve, është i nevojshëm disponimi edhe i makinës së pastrimit kimik, me qëllim që larja e këtij materiali të kryhet në përputhje me specifikimet teknike të vendosura nga AK.

Duke qenë se njësia matëse e objektit të prokurimit, është kg, dhe OE do të ofertojnë për njësinë në kg, disponimi i peshores, lidhet drejtëpërdrejtë me ekzekutimin me sukses të kontratës.

Disponimi i këtyre mjeteve (lloji, sasia dhe pesha) është vendosur bazuar në proceset e punës të shërbimit objekt prokurimit, si dhe sasisë së parashikuar nga AK të materialeve që do të lahen, duke shërbyer si garanci e AK që shërbimi, objekt prokurimi do të kryhet me cilësi dhe konform të gjitha kërkesave të AK.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi 1 (një) mjet transport, me qëllim transportin e materialit të butë, të cilin duhet ta ketë në pronësi, huapërdorje ose me qira.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet:

- dokumentacion për pajisjet dhe instrumentet e mësipërme, që vërtetojnë se, këto pajisje dhe instrumente i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).
- lejen e qarkullimit të mjetit

Të dhënat që do të deklarohen, detyrimisht do t'i paraqiten Autoritetit Kontraktor, për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 11 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihet në dispozicion të paktën një mjet, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Kërkesa për disponimin e një mjete lidhet ngushtësisht me procesin e transportimit të materialit të butë, nga lavanderia në ambientet e Spitalit dhe anasjelltas, pjesë e pandashme e realizimit të shërbimit të lavanderisë dhe përmbushjes së kërkesave në kohë të AK.

**2.3.9** Operatori ekonomik, duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër kryerjen e shërbimeve, nga punonjës të pajisur me uniformën e punës, me materiale/ pajisje mbrojtëse personale për shëndetin dhe sigurinë teknike në punë.

**Argumentimi:** Kjo kërkesë vendoset në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Duke iu referuar natyrës së objektit të prokurimit, specifikeve teknike dhe termave të referencës, dhe rrezikshmërinë që paraqesin materialet me ndotje spitalore, është e rëndësishme për AK të krijojë siguri që ofertuesi do të kryejë shërbimin e lavanderisë, duke garantuar shëndetin dhe sigurinë teknike në punë të punëmarrësve të angazhuar me kryerjen e këtij shërbimi.

**2.3.10** Operatori ekonomik, duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër shërbimin e larjes me produkte, cilësia CE/ dhe ose/të pajisur me certifikatë konformiteti.

**Argumentimi:** Në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Duke vlerësuar ndotjen dhe rrezikshmërinë që mbartin materialet spitalore, dhe rëndësinë e larjes së këtyre materialeve me cilësi, pasi lidhet drejtëpërdrejtë me shërbimin ndaj pacientëve, operatori ekonomik duhet të garantojë se për shërbimin e lavanderisë do të përdorë produkte cilësore, me certifikatë konformiteti ose cilësi CE.



**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

*Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentat e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentat e kërkuar sipas legjislacionit të fushës.*

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

Specifikimet teknike, termat e referencës dhe përlogaritja e fondit limit janë përgatitur dhe hartuar nga Autoriteti Kontraktor “Spitalin Rajonal Lezhë”, për nevojat e së cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”, i ndryshuar.

## LOTI 2: SHËRBIM LAVANDERIE PËR SPITALIN RAJONAL BERAT

### KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 11;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 5;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

#### 2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kritereve të përgjithshme të kualifikimit, të vendosura në pikën 1 të shtojcës 10 të DST.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", duke vlerësuar që plotësimi i kritereve të përgjithshme të kualifikimit, të vendosura në pikën 1 të shtojcës 10 të DST provon mjaftueshëm përshtatshmërinë profesionale të ofertuesve.

#### 2.2.Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

**2.2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2021-2022-2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e vlerës së përlllogaritur të fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/b të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomik-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka

mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2021, 2022, 2023), të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentim:** Kriteri vendoset bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP; të nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, si dhe të nenit 41 të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar", i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Kriteri ekonomik dhe financiar i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar sigurinë se operatorët ekonomik kanë kapacitetin financiar për zbatimin e marrëveshjes kuadër.

### **2.3.Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit të limitit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, nenit 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % të vlerës së fondit limitit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar marrëveshjen kuadër, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike. Garancia mbi përvojën e ngjashme është e rëndësishme, duke mbajtur në konsideratë natyrën e objektin e prokurimit, që lidhet drejtëpërdrejtë me shërbimin e pacientëve në spital.

### 2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë në pronësi, qira ose në përdorim **të paktën 1 (një) ambient, ku shtron veprimtarinë për kryerjen e shërbimit lavanderisë objekt prokurimit.**

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- dokumentacionin që vërteton pronësinë, ose qiramarrjen, ose huapërdorjen (certifikatë pronësie/ kontrata qiraje/ kontrata huapërdorje/ çdo dokument tjetër të vlefshëm, me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).
- akt miratimi higjeno – sanitar për këtë ambient, lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.

Të dhënat e ambientit të kërkuar që do të deklarohet, detyrimisht do t'i paraqiten Autoritetit Kontraktor, për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Nisur nga fakti se shërbimi, objekt prokurimi është lavanderia, vlerësohet e nevojshme që operatori ekonomik duhet të disponojë një ambient për kryerjen e këtij shërbimi dhe i të gjitha proceseve të punës, që ky shërbim përfshin, si: larje, dizinfektim, tharje, hekurosje, paketim. Disponimi minimalisht i 1 (një) ambjenti ku ushtron aktivitetin e tij, i cili plotëson kushtet higjeno-sanitare, siguron AK që shërbimi i lavanderisë, objekt prokurimi, do të kryeht në kohë, cilësi dhe konform kushteve higjeno-sanitare.

Pajisja me aktin higjeno-sanitar e këtij ambienti, është vendosur bazuar në Ligjin nr. 7643 datë 02.12.1992 ”Për inspektimin sanitar”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 139, datë 14.4.2011, “Për lëshimin e akt miratimit higjeno-sanitar”, Udhëzimin nr.510, datë 13.12.2011, “Për inspektimet higjeno-sanitare në funksion të lëshimit të akt miratimit higjeno-sanitar, si dhe duke mbajtur në vëmendje rëndësinë që ka ruajtja dhe plotësimi i kushteve të higjenës, për këtë shërbim, i cili lidhet drejtëpërdrejt me shëndetin e pacientëve në spitale.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë dhe të paraqesë çertifikatë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, dhe të jetë e vlefshme, si më poshtë si më poshtë:

- **SSH EN 14065:2016** mbi “Sistemin e kontrollit të Biokontaminimit”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e kontrollit të Biokontaminimit. Nisur nga rëndësia dhe frekuencat e kryerjes së proceseve të shërbimit, objekt prokurimi, është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj

procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të tille, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte që plotësojnë kërkesat AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit ndaj klientit, pra Ak-së . Ky standard evropian përshkruan një qasje të menaxhimit të rrezikut, të quajtur analiza e rrezikut dhe kontrollit të biokontaminimit (RABC), i projektuar për të lejuar pastrimin e produkteve të vazhdueshme për të siguruar cilësinë mikrobiologjike të indeve të trajtuara në lavanderi, pra lidhet ngushtësisht me objektin e prokurimit, pasi pjesa kryesore e objektit të prokurimit është larja e materialeve, të cilat pasi të lahen do të përdoren për shtretërit e pacientëve të sëmurë, apo personelit mjekësor, si dhe për sallat e operacioneve, ku çdo gjë duhet të jetë sa më sterile dhe e pastër.

2.3.4. Operatori ekonomik ofertues, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë leje mjedisore të Tipit B “Pastrim kimik” (të vlefshme), lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), për vendin ku ushtron këtë aktivitet, në fushën e objektit të prokurimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 5, gërma c,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe Ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011 ”Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar, Ligjit nr. 52/2020 ”Për disa ndryshime në ligjin nr.10448, datë 14.07.2011 ”Për lejet e mjedisit”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë lejen mjedisore që parashikohet nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore.

Pajisja me këtë leje mjedisore, siguron AK që ofertuesit ushtrojnë aktivitetin e tyre në zbatim kërkesave ligjore mjedisore, si dhe shërben si garanci që ekzekutimi i marrëveshjes kuadër, do të kryhet nga OE në përputhje me standartet e kërkuara ligjore dhe cilësinë e shërbimit, që kërkohet të ofrohet.

2.3.5. Operatori/ët ekonomik pjesëmarrës për të realizuar shërbimin objekt prokurimi, duhet të ketë minimalisht 5 (pesë) persona të punësuar, në profilet sipas tabelës si mëposhtme:

NR.	Stafi	Nr.
a)	Drejtues Teknik	1 (një)
b)	Punëtore në Lavanderi	2 (dy)
c)	Punonjës shërbimi në Reparte të AK	2 (dy)
	<b>Totali i punonjësve</b>	<b>5 (pesë)</b>

a) Drejtuesi Teknik duhet të ketë eksperiencë pune të ngjashme të paktën 2 (dy) vite.

Për Drejtuesin Teknik, OE duhet të paraqesë:

- Kontratë individuale pune (e vlefshme), si drejtues teknik;
- Diplomë e arsimit të lartë;
- Librezë pune/ deklaratë e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/ cv dhe/ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton ekspseriencën e kërkuar.

b)Për punonjësit Punëtor në Lavanderi, dhe punonjësit e shërbimit në Reparte të AK të paraqitet vetëm kontratë individuale pune (e vlefshme) përkatëse.

Të dhënat për punonjësit e kërkuar që do të deklarohen, detyrimisht do t’i paraqiten Autoritetit Kontraktor për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

*Kriteri konsiderohet i permbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 11 të DT.*

Dokumentet provuese të kërkuar më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për punonjësit vendoset nga një analizë e natyrës së objektit të prokurimit, specifikimeve teknike, frekuencës së ekzekutimit të kontratës/ava, që do të lidhen dhe termave të referencës, hartuar nga AK.

Në tabelën e mësipërme është përcaktuar numri minimal i punonjësve, të cilët vlerësohen të nevojshëm për kryerjen e proceseve të punës, të cilat përfshin shërbimi i lavanderisë, si më poshtë: Drejtuesi teknik ka një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e shërbimit të lavanderisë, dhe të gjitha proceseve të punës, të përfshirë në këtë proces, duke mbajtur përgjegjësi për zbatimin e objektit të prokurimit, në përmbushje të standarteve të cilësisë, specifikimeve teknike, dhe kushteve teknike të kërkuara. Vitet e eksperiencës për drejtuesin teknik, janë vendosur duke mbajtur në konsideratë rëndësinë e shërbimit, objekt prokurimi dhe kryerjen e tij në përputhje cilësinë dhe me oraret e vendosura nga AK.

Disponimi i punëtorëve në lavanderi siguron AK që ofertuesit zotërojnë personelin e nevojshëm për të kryer proceset e larjes, tharjes, hekurosjes, paketimit, në kohë dhe me cilësinë e kërkuar.

Punonjës shërbimi në reparte janë të nevojshëm për të kryer proceset e marrjes së materialeve nga spitali dhe transportimin e tyre në spital.

Numri i punonjësve të kërkuar është caktuar duke u bazuar në natyrën dhe numrin e shërbimeve, objekt prokurimi dhe proceset e punës në të cilat duhe të përmbushë ky shërbim.

Dokumentacioni i kërkuar për punonjësit shërben si provë/dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

2.3.6 Operatorët ekonomikë ofertues duhet të deklarojnë se punonjësit e deklaruar për këtë procedurë prokurimi: Drejtuesi Teknik dhe Punonjës shërbimi në Reparte të AK nuk do të jenë të angazhuar në kontrata të tjera gjatë periudhës së vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër.

**Argumentimi:**

Në zbatim të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i cili lejon Autoritetin/entit kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, si dhe duke vlerësuar ndjeshmërinë e shërbimeve, objekt prokurimi, ku kërkohet një shërbim i përditshëm, vlerësohet e nevojshme që: drejtuesi teknik dhe punonjësit e shërbimit në reparte të AK të mos jenë të angazhuar në kontrata të tjera gjatë periudhës së vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër, duke garantuar kështu ekzekutimin e kontratës/kontratave që do të nënshkruhen në zbatim të marrëveshjes kuadër, në kohë dhe cilësi. Realizimi në kohë i shërbimit, objekt prokurimi është shumë i rëndësishëm për këtë procedurë prokurimi, pasi lidhet drejtëpërdrejtë me shërbimin ndaj pacientëve në spitale.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se disponon, makineritë, dhe pajisjet, si më poshtë:

Nr	Emri i mjetit	Njësia	Sasitë minimale	Statusi
1	Makine larëse Profesionale (me kapacitet mbi 60 kg secila)	Cope	2 (dy) ose me kombinim pajisjesh, për plotësimin e sasisë se përcaktuar nga AK.	Në pronësi ose me qira, ose përdorim
2	Makinë tharëse profesionale (me kapacitet mbi 20 kg secila)	copë	2 (dy) ose me kombinim pajisjesh, për plotësimin e sasisë së përcaktuar nga AK	Në pronësi ose me qira, ose përdorim
3	Makinë Hekurose (Rul) Profesionale	Copë	1 (një)	Në pronësi ose me qira, ose përdorim
4	Peshore elektronike mbi 100 kg e cila duhet të jete kalibruar dhe të shoqerohet me akt kolaudimi të leshuar nga autoritetet perkatese( Drejtoria e Pergjithshme e Metrologjise)	Copë	1 (një) ose me kombinim pajisjesh, për plotësimin e sasisë se përcaktuar nga AK.	Në pronësi ose me qira, ose përdorim

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet:

dokumentacion për pajisjet dhe instrumentet e mësipërme, që vërtetojnë se, këto pajisje dhe instrumente i ka në pronësi, ose me qira, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Të dhënat për pajisjet e kërkuara që do të deklarohen detyrimisht do t'i paraqiten Autoritetit Kontraktor, për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

*Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 11 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit,ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet për kryerjen e shërbimit të lavandersisë dhe të gjitha proceseve të tij, si: larje, tharje, hekurosje.

Duke qenë se njësia matëse e objektit të prokurimit, është kg, dhe OE do të ofertojnë për njësinë në kg, disponimi i peshores, lidhet drejtëpërdrejtë me ekzekutimin me sukses të kontratës.

Disponimi i këtyre mjeteve (lloji, sasia dhe peshë) është vendosur bazuar në proceset e punës të shërbimit objekt prokurimit, si dhe sasisë së parashikuar nga AK të materialeve që do të lahen, duke shërbyer si garanci e AK që shërbimi, objekt prokurimi do të kryhet me cilësi dhe konform të gjitha kërkesave të AK.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi 1 (një) mjet transport, me qëllim transportin e materialit të butë, të cilin duhet ta ketë në pronësi, huapërdorje ose me qira, sipas tabelës së mëposhtme:

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet:

- dokumentacion për pajisjet dhe instrumentet e mësipërme, që vërtetojnë se, këto pajisje dhe instrumente i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).
- lejen e qarkullimit të mjetit

Të dhënat që do të deklarohen, detyrimisht do t'i paraqiten Autoritetit Kontraktor, për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

*Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 11 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit,ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihet në dispozicion të paktën një mjet, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Kërkesa për disponimin e një mjeti lidhet ngushtësisht me procesin e transportimit të materialit të butë, nga lavanderia në ambientet e Spitalit dhe anasjelltas, pjesë e pandashme e realizimit të shërbimit të lavanderisë dhe përmbushjes së kërkesave në kohë të AK.

**2.3.9** Operatori ekonomik, duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër kryerjen e shërbimeve, nga punonjës të pajisur me uniformën e punës, me materiale/ pajisje mbrojtëse personale për shëndetin dhe sigurinë teknike në punë.

**Argumentimi:** Kjo kërkesë vendoset në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Duke iu referuar natyrës së objektit të prokurimit, specifikimeve teknike dhe termave të referencës, dhe rrezkshmërinë që paraqesin materialet me ndotje spitalore, është e rëndësishme për AK të krijojë siguri që ofertuesi do të kryejë shërbimin e lavanderisë, duke garantuar shëndetin dhe sigurinë teknike në punë të punëmarrësve të angazhuar me kryerjen e këtij shërbimi.

**2.3.10** Operatori ekonomik, duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër shërbimin e larjes me produkte, cilësia CE/ dhe ose/të pajisur me certifikatë konformiteti.

**Argumentimi:** Në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.



Duke vlerësuar ndotjen dhe rrezikshmërinë që mbartin materialet spitalore, dhe rëndësinë e larjes së këtyre materialeve me cilësi, pasi lidhet drejtëpërdrejtë me shërbimin ndaj pacientëve, operatori ekonomik duhet të garantojë se për shërbimin e lavanderisë do të përdorë produkte cilësore, me certifikatë konformiteti ose cilësi CE.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

*Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentat e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentat e kërkuar sipas legjislacionit të fushës.*

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

Specifikimet teknike, termat e referencës dhe përlllogaritja e fondit limit janë përgatitur dhe hartuar nga Autoriteti Kontraktor “Spitalin Rajonal Berat”, për nevojat e së cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”, i ndryshuar.

## **NJËSIA E PROKURIMIT**